



"për një Shqipëri më të mirë"

"për bashkimin e vërtetë të kombit"

"për mbarëvajtjen e atdheut"



## **FJALA E PROFESOR REMZI HASANI, SHQIPTAR NGA KOSOVA NË 100 VJETORIN ENVER HOXHËS**

Përshëndetje të zjarra nga Kosova për Komitetin Qëndror të Partisë Komuniste të Shqipërisë!

Respekt dhe nderime për familjen e shokut Enver Hoxha!

Përshëndetje për të gjitha delegacionet dhe pjesëmarrësit e tjerë të cilët kanë ndarë kohën që sot jemi së bashku në këtë sesion jubilar, për të përkujtuar dhe nderuar shokun Enver Hoxha me rastin e 100-vjetorit të lindjes së tij.

Të nderuar vëllezër e motra, shoqe dhe shokë, flamurtarë të zbatimit të mësimëve dhe rrugës revolucionare të shokut Enver Hoxha, me sinqeritet maksimal e them se kam një emocion të veçantë këto çaste dhe rrethana kur ndodhem në hapësirat dhe i bashkuar me njerëz me të cilët për gjysmë shekulli jetoj dhe veproi njeriu i ynë më i dashur dhe më i çmuar në historinë mijëvjeçare të popullit tonë, shoku Enver Hoxha.

Dikur filozofi i madh i lashtësisë greke – Platoni pati thënë: I falënderoj perënditë që më lindën grek e jo barbar, i falënderoj perënditë që më lindën aristokrat dhe jo skllav dhe në fund i falënderoj perënditë që urdhëruan të lind në kohën kur jetoj Sokrati i urtë.

Unë i përdora këto konstatime të këtij filozofi të madh sa për të bërë një komperacion dhe për të thënë se edhe unë së bashku me shokët e mi nga Ferizaj dhe e gjithë Kosova e kemi për nder dhe krenari që kemi fatin të jemi pasardhës besnikë të veprimtarisë dhe rrugës revolucionare të shokut Enver Hoxha.

Të nderuar shokë, po sa u informuam se Komiteti Qëndror i Partisë Komuniste të Shqipërisë që nga tetori i vitit 2007 e kishte shpallur vitin 2008 si viti i Enverit edhe ne nga ana jonë i bashkuam forcat dhe i konsoliduam rradhët me qëllim që sesioni jubilar kushtuar 100 vjetorit të lindjes së shokut Enver Hoxha të kremtohet në mënyrë sa më të dinjitetshme.

Prandaj në këto çaste të shënuara, ne sot jemi krenarë më tepër se asnjëherë më parë, sepse evokojmë kujtime për Antifashistin e orëve të para të Rezistencës, Kapedanin e përgjithshëm të Shtabit Qendror të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare të Shqipërisë, për ideologun dhe revolucionarin e çlirimit dhe rimëkëmbjes së vegjëlisë, për Komandantin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës Popullore së Shqipërisë, për burrshtetasin dhe arkitektin e Shqipërisë së re, përkatësisht për njeriun tonë më të dashur dhe më të nderuar Enver Hoxha.

“Populli shqiptar me shpatë në dorë e ka çarë rrugën e historisë” thoshte shoku Enver Hoxha. Në historinë e përplasjeve të përgjakshme dhe rezistencës gjatë përjetimit të tragjedive, populli ynë ka ngritur në skenën e historisë shumë personalitete dhe figura legjendare, por Enver Hoxha ishte personaliteti më i shquar që ka njohur ndonjëherë historia e deritanishme e Shqipërisë. Enver Hoxha ishte ai tribun popullor i cili në ërrësirën e plotë pa diellin që do të ndriçonte, në robërinë dhe varfërinë e thellë pa lirinë dhe begatinë që po agonte,

*Enver Hoxha*

"për një Shqipëri më të mirë"

"për bashkimin e vërtetë të kombit"

"për mbarëvajtjen e atdheut"



ishte ai i cili duke i bashkuar masat e gjëra popullore i hodhi themelet e Shqipërisë së Re. Enver Hoxha ishte personalitet i cili bëri epokë të lavdishme në historinë moderne të Shqipërisë, duke qëndruar për pesë dekada me radhë në ballë të stuhive dhe shtërngatave të pamëshirshme të cilat kohë pas kohe përplaseshin në brigjet e Adriatikut. Pra, Enveri ishte ai i cili kishte të ngulitura rrënjët thellë në gjakun popullor.

Shoku Enver, duke përjetuar rëndë mbi supe që në rininë e tij të hershme si shtypjen dhe eksploatimin e pamëshirshëm klasor që e prodhonte regjimi antipopullor zogollian, po ashtu edhe moszgjdhjen e drejtë të çështjes nacionale të popullit tonë dhe tendencat hegjemoniste të cilat pëherë ishin në rritje për ta ricoptuar Shqipërinë që vinin nga orekset e shovinistëve fqinjë dhe reaksioni ndërkombëtar, këto fatkeqësi që po i hidheshin vërdallë nga mbrapa popullit tonë, ndikuar që i riu Enver Hoxha në vitin 1936 të betohet para verit të Bajo Topullit se do të luftonte pandërprerë, derisa në një shtet të vetëm ta bashkojë Shqipërinë dhe shqiptarët përgjithësisht.

Dhe siç është e njohur botërisht një pjesë të këtij përcaktimi që fuqishëm i shërben çështjes së përgjithsme të Atdheut dhe bashkimit të kombit shoku Enver e përmbushi në nëntor të vitit 1972 në kongresin drejtshkrimor që shënon etapën e parë fillestare, por shumë të rëndësishme për bashkimin shpirtëror-kulturor për të gjithë shqiptarët kudo në botë.

Në vitin 1939 kur mbi Shqipërinë vërshoi arsenali fshist italian dhe rezistenca e armatosur do të duhej të fillonte normalisht nga trupa ushtarake e kryemonarkut zogollian. Megjithatë, një gjë e tillë nuk ndodhi sepse Zogu si Zog që ishte e mblodhi thesarin kombëtar, e vodhi atë dhe fluturoi jashtë qiellit të Shqipërisë, duke e braktisur popullin, të cilin e kishte mbytur në varfëri, shkop a vaj dhe duke e lënë të vetmuar përballë një stuhie të fuqishme e të tërbuar siç ishte fashizmi.

Ishte Enver Hoxha ai i cili mblodhi forcat patriotike brenda për brenda grupimeve komuniste shqiptare, duke i hedhur kështu themelet e një profili të ri politik – Partia Komuniste të Shqipërisë, e cila mori mbi vete një nga përgjegjësitë më të rënda, më fisnike, por dhe më të lavdishme në historinë e deritanishme të Shqipërisë, inicimin, fuqizimin dhe masivizimin e Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare, luftë kjo më e përgjakshmja dhe më e lavdishmja në historinë e popullit tonë.

Enver Hoxha përpos që ishte në ballë të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, luftë kjo e cila e çliroi vendin nga dinastitë fashiste dhe regjimet antipopullore, ai të njëjtën kohë Shqipërisë i siguroi një prestigj të fuqishëm e të nderuar edhe në arenën ndërkombëtare, sepse Shqipëria përbënte një nga pikat më të fuqishme luftarake në koalicionin e madh botëror kundër fashizmit.

Gjithashtu, gjatë dekadës së Luftës së Ftohtë në mes të dy blloqeve agresive, ishte Enver Hoxha ai i cili arriti t'i sfidojë me zgjuarsi konfrontimet dhe kompletet ndërkombëtare të akorduara kundër Shqipërisë dhe me fuqi të paimagjinueshme e zhvilloi vendin dhe e ndërtoi që nga themeli Shqipërinë e Re, duke e bërë atë kala të pamposhtur në të cilën e morën goditjen vdekjeprurëse të gjitha agjenturat dhe qendrat e spiunimit ndërkombëtar, të cilat moto të veprimtimit kishin përmbysjen

*Enver Hoxha*

"për një Shqipëri më të mirë"

"për bashkimin e vërtetë të kombit"

"për mbarëvajtjen e atdheut"



e atdheut tonë, por që pa e parë dot diellin e Shqipërisë. Këto agjencia u shpartalluan dhe u likuiduan fizikisht. Pra Enver Hoxha i siguroi një mbrojtje të rrufeshme vendit sipas modelit: po të rrezikohej dhe cënohej atdheu, në vullkan do të kthehej Shqipëria.

Enveri ishte ai që Shqipërinë e nxori nga analfabetizmi dhe errësira e shekujve, që e mbrojti popullatën të paprekur nga papunësia, ndërhyrja e kapitalit të huaj botëror në fuksion të skllavërimit të popullit shqiptar, e mbrojti të paprekur nga droga, sida e prostitucioni, nga pasiguria shoqërore sociale e shëndetësore – sëmundje këto që tanimë po godasin shpirtin e njerëzimit në përmasa botërore, e për fat të keq edhe të shqiptarit në Shqipërinë pasenveriane – thjeshtë atë mirëqenie shoqërore, ekonomike dhe stabilitet politik që kishte realizuar populli i Shqipërisë me Enver Hoxhën në krye për vite dhe dekada të tëra, duke ngritur fabrika, uzina, kombinatë, kantiere detare, liqej arificalë, plantacione me drunjtë frutorë, gjigante të fuqishëm elektrikë e kështu me radhë. Pas viteve të nëntëdhjeta një dorë e fuqishme antipopullore e ndihmuar edhe nga reaksioni ndërkombëtar, goditi dhe shkatërroi çdo gjë që nga themeli, duke e kthyer Shqipërinë e pas viteve të nëntëdhjeta jo vetëm në një vend lypsar që do të vuante edhe për bukën e gojës, por edhe duke e kthyer vendin në mënyrën më të turpshme në një poligon të fuqishëm të krimit të organizuar, të pasigurisë ekonomike, të varfërisë ekstreme shoqërore, të diferencave marramendëse sociale në të pasur dhe të varfër, ku dëshira për fitim të paligjshëm nuk e kursen as trafikimin dhe stërshitjen e qenieve njerësore.

Të nderuar shokë, shpërthimi tragjik që ndodhi në Gërdec, tek ne në Kosovë ua çorri maskën të gjitha fundërrinave titiste, të cilat në vazhdimësi nuk kishin pushuar duke hedhur baltë mbi Shqipërinë dhe figurën legjendare të Enver Hoxhës, duke thënë me humor të zi përbuzës se ja sa e fuqishme ushtarakisht na ishte Shqipëria e Enverit, i kishte nja dy tanke të amortizuar të cilat nuk lëviznin dot vetëm se duke i tërhequr me qe dhe ndonjë avion luftarak që nuk fluturon dot dhe se në veprim mund të vihet vetëm duke e tërhequr zvarrë me traktor. Por për fat të keq u desht të ndodhë një shpërtim mjaft i fuqishëm që tronditi tërë Ballkanin, me ç'rast ua mbylli gojën edhe kundërshtarëve më të tërbuar kundër Enverit të cilët më në fund e kuptuan se Shqipëria e asaj kohe ishte edhe më e fuqishme se ç'thoshte vetë Enveri **"një shkëmb graniti ku do t'i thyenin hundët të gjithë ata që do të merrnin guxim për të cenuar sovranitetin dhe tërësinë territoriale të Shqipërisë"**. E këtë më së miri e kishte dëshmuar konfrontimi me sovjetikët në vitet e gjashtëdhjeta, ku porosia e shokut Enver drejtuar kontigjentit ushtarak të Vlorës ishte që Pasha Limani të mbrohet me çdo kusht dhe sakrificë, bëri që ushtria sovjetike, e cila atëbotë ishte perandoria më e fuqishme ushtarake e planetit të shporrej me bishtin në shalë nga hapësirat shqiptare.

Pra, sipas të dhënave të ekspertëve ushtarakë Shqipëria e Enver Hoxhës ishte e përgatitur ushtarakisht edhe për më tepër se për dy lufta të mëdha botërore. Thjeshtë atë arsenal lufte që Shqipëria e posedonte në të kaluarën në fuksion të ndëshkimit të cenesve të tërësisë teritoriale të atdheut. Diletantët e tanishëm të jetës politike shqiptare, po e përdorin qoftë për trafikim armësh, për përfitime materiale, e qoftë për të goditur vetë popullatën e Shqipërisë. Ata që përmes votës se tyre i sollën të pameriturit në majë të piramidës pushtetare.

*Enver Hoxha*

"për një Shqipëri më të mirë"

"për bashkimin e vërtetë të kombit"

"për mbarëvajtjen e atdheut"



Të nderuar të pranishëm, Enver Hoxha për pesë dekada me radhë e përballoi me vigjilencë dhe heroizëm çdo ndërhyrje nga jashtë që e synonte pushtimin e Shqipërisë, kurse udhëheqja e tanishme shqiptare këtë luftë kundër pushtuesve të huaj e kthyen në luftë të shqiptarit kundër shqiptarit.

Prandaj këto janë arsyet për të cilat ne mendojmë se Shqipëria e Enver Hoxhës me potencialin ekonomik që posedonte për kokë banori dhe sidomos me aftësinë mbrojtëse luftarake konform territorit dhe popullatës që do të duhej ta mbronte, pa dyshim se ishte shteti më i fuqishëm i planetit dhe pikërisht këtu qëndron mbështetja që ne mendojmë se personalitetet historike si Skënderbeu dhe Enver Hoxha, vetëm në skajet e pesëqindvjetorëve, mund t'i krijoë historia e lavdishme e Shqipërisë, kurse në anën tjetër një personalitet i tillë po të kishte patur fat të ishte në ballë të ndonjë superfuqie botërore, falë inteligjencës, guximit dhe revolucionaritetit që posedonte, për tridhjetë shekuj do të ishte njeriu i pa zëvendësueshëm në historinë e planetit.

Të nderuar shokë, aktualisht në mesin tonë tani e më tepër se njëzet e tri vite nuk ndodhet fizikisht shoku Enver për të bërë ndryshime epokale në këtë rrugëtim të egër, e të mbuluar nga errësira që po kalojmë. Personalisht mendoj se në truallin shqiptar edhe për një kohë të gjatë do të mungojë një personalitet i tillë.

Por në qoftë se fizikisht mungon shoku Enver për t'i zhvilluar dhe dirigjuar proceset dhe ngjarjet e vrullshme shoqërore në Shqipëri dhe gjithandej ku jetojnë shqiptarët, nuk mungojnë mësimet, idetë dhe rruga e tij revolucionare, për të ndërtuar ardhmërinë tërësisht të sigurtë të popullit tonë.

Për ne kosovarët që ruajmë me respekt kujtimin për komandantin legjendar, fjalët e shokut Enver ishin si një vullkan i pashuar, që na jepnin fuqi mobilizimi dhe veprimi për tu përballuar dhëmb për dhëmb me shovinizmin serbo-malazez dhe atë jugosllav përgjithësisht.

Prandaj kolosin tonë legjendar që nuk arriti dot ta mposhtë asnjë fuqi planetare e mbar globit tokësor, më njëmbëdhjetë prill të vitit 1985 e nënshtruan ligjet e natyrës. Ne që kemi nderin të jemi pasardhës besnikë të shokut Enver Hoxha në këto çaste kur krahas krenarisë përjetojmë edhe plagët nga më të rëndat, dhimbjen do të kthejmë në forcë dhe lotët në qëndresë sepse kjo ishte porosia dhe amaneti i fundit nga shoku i ynë më i dashur dhe i paharruar Enver Hoxha.

Në fund dëshiroj të garantoj Partinë Komuniste të Shqipërisë, organizatore e këtij sesioni jubilar, se në Kosovë gjithmonë do të ketë një bërthamë të fuqishme mbështetjeje për aq sa kjo parti është besnike në rrugën e Enverit.

I përmotshëm qoftë kujtimi për shokun Enver Hoxha.

Lavdi jetës dhe veprës së tij.

Dhe ju shokë të nderuar, pjesëmarrës të këtij sesioni jubilar që nderon jetën dhe veprën e Enver Hoxhës në njëqindvjetorin e lindjes së tij, qofshi gjithmonë më shëndet të mirë dhe me zemrën zjarr.